

RAPORT STUDIMOR
“VEPRAT PENALE TË
KORRUPSIONIT, FORMAVE TË
SHPËRDORIMIT TË DETYRËS DHE
LUFTA NDAJ LËNDËVE NARKOTIKE”

Tiranë, më Maj 2021

Periudha e Studimit: 6 muaj
Nëntor 2020 – Prill 2021

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.



1. HYRJE

Qendra “Fol” gjatë muajve Nëntor 2020 – Prill 2021 ka monitoruar në mënyrë proaktive dinamikën e kryerjes së veprave penale që kanë si qëllim goditjen e fenomenit të korrupsionit të kryer nga funksionarë publikë, të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cënimin e interesit publik dhe integritetit institucional e shtetëror, si dhe vëmendjen që i është dhënë nga ana e ligjvënësit luftës kundër drogës, prodhimit, trafikimit, shitjes dhe formave të tjera të lëndëve narkotike psikotrope, të cilat paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore për jetën dhe shëndetin e njeriut.

Referuar kategorisë së parë të veprave penale në fushën e korrupsionit, 23 dispozita të Kodit Penal shërbyen si referencë e punës së ekspertëve të Qendrës “Fol”, ndërsa në kategorinë e dytë të veprave penale objekt studimi në fushën e drogërave rreth 10 dispozita u shndërruan në objekt studimi.

Më herët, ekspertët e Qendrës Fol publikuan Raportin e Monitorimit 3 mujor “Veprimtaria dhe Vigjilenca e Institucioneve në luftën ndaj lëndëve narkotike”, në të cilin reflektohen të dhënat për periudhën Nëntor 2020 – Janar 2021. Për shkak të vijueshmërisë së ndërmarrjes së vendimeve të tjera nga ana e autoriteteve proceduese dhe atyre gjyqësore, ekspertët e Qendrës Fol në funksion të transparencës dhe informimit objektiv të publikut të gjerë do të reflektojnë nëpërmjet këtij Raporti Studimor 6 mujor të dhënat e grumbulluara dhe të vlerësuara nga fillimi i zbatimit të projektit, periudhë e cila përfshin muajt Nëntor 2020 – Prill 2021.

Referuar të dhënave në fushën e drogërave, në formën e përmbledhjes ekzekutive rezulton se:

1. Gjatë kësaj periudhe 6 mujore **640** shtetas rezultojnë të proceduar në qarkun Tiranë. **191** prej këtyre shtetasve ose rreth 30% rezultojnë të jenë arrestuar në flagrancë nga ana e forcave të rendit. **449** shtetas ose rreth 70% konstatohen të proceduar në gjendje të lirë. Nga 640 raste të proceduara penalisht rezulton se 19 raste ose rreth 3% janë hetuar, proceduar dhe gjykuar nga ana e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. **Ndaj 327** rasteve ose 51% organi procedues ka përmbyllur fazën e hetimeve paraprake duke marrë vendim mosfillimi të procedimit penal, ndërkohë që vendim për pushimin e çështjes ose akuzës rezulton të jetë disponuar vetëm në 2 raste. **Ndaj 39** shtetasve ose rreth 20% të numrit total të shtetasve të arrestuar, organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Kjo masë siguri është aprovuar nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor në dy shkallët e gjykimit, konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit. Ndërkohë 14 shtetas janë proceduar penalisht nga ana e SPAK dhe janë nën “arrest me burgim”. Masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” u kërkuar nga ana e prokurorëve të çështjeve në **13** raste ose rreth 6.8%, ndërkohë që në vetëm 5 raste, 1 prej të cilave nën kompetencën e SPAK kjo masë u la në fuqi nga të dyja shkallët e gjykimit. Lidhur me 8 rastet e tjera rezulton se Gjykata e Apelit ende nuk

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

është shprehur mbi rastet, ose palët nuk kanë depozituar ankim, duke lënë në fuqi këtë masë siç ka disponuar Gjykata e Shkallës së Parrë. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është kërkuar nga ana e organit të akuzës ndaj 82 shtetasve ose rreth 12.8% të numrit total të shtetasve të proceduar penalisht. Ndaj 80 shtetasve ose rreth 98% e rasteve ndaj të cilëve është kërkuar caktimi i kësaj mase, kërkesa e prokurorit është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Ndërkohë vetëm në 5 raste, 2 prej të cilave nën kompetencën e SPAK, rezulton se vendimi për caktimin e masës së sigurimit është ankimuar, por dhe nga ana e Gjykatave të Apelit u aprovua vendimi i dhënë nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

2. 16 prej këtyre shtetasve ose rreth 2.5% e numrit total janë shtetas të mitur, pra nën moshën 18 vjeç. Gjatë 2 mujorit të fundit të vitit 2020 rreth 231 shtetas janë kualifikuar si autorë të dyshuar, duke përbërë rreth 36% të numrit total të shtetasve.

12 prej këtyre shtetasve janë të mitur (ose rreth 71%), të proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 K.P., në formën e prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike. 4 shtetas të mitur (ose rreth 24%) janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 283 K.P., në formën e “shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit, dorëzimit, si dhe mbajtjes”. Vetëm 1 shtetas është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale të “nxitjes për përdorimin e drogës” të parashikuar nga neni 286 K.P., por në këtë rast subjekti viktimë i veprës penale ka qenë i mitur.

3. 442 shtetas ose rreth 69% e numrit total të shtetasve të proceduar për të gjitha figurat e veprave penale në fushën e drogërave, rezultojnë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283 K.P. Rreth 326 shtetas ose rreth 74% e numrit total të janë proceduar në gjendje të lirë. 141 shtetas ose rreth 22% e numrit total të shtetasve të referuar si autorë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave, rezultojnë të jenë proceduar penalisht si të dyshuar për mbajtjen, shitjen ose shpërndarjen e lëndës narkotike sipas nenit 283/1 K.P. Ndaj 65 shtetasve të proceduar në gjendje të lirë për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 K.P. ose rreth 73% e numrit total të shtetasve të proceduar, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Vetëm 43 prej tyre ose rreth 30% e rasteve rezultojnë të jenë arrestuar nga ana e forcave të rendit. Për 17 shtetas ose rreth 12% e numrit total të shtetasve të proceduar penalisht, organi i akuzës kërkonte caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Në 10 raste kjo masë e sigurimit e kërkuar nga ana e prokurorit, u aprovua nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që shqyrtimi në Apel duke lënë në fuqi këtë masë u përfundua vetëm në 4 raste. Vetëm në 2 raste organi i akuzës kërkonte caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila u aprovua nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë ndaj 25 shtetasve të tjerë Prokuroria kërkonte caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

4. 20 shtetas ose rreth 3.1% e numrit total janë proceduar penalisht si të dyshuar për prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike në rrethana cilësuese. Në 2 prej këtyre rasteve është konstatuar konkurrimi i kësaj veprë penale me nenet 285/a “përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe 283 “prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”.
5. 20 shtetas rezulton se janë proceduar penalisht si të dyshuar për kultivimin e bimës narkotike, të parashikuar nga neni 284 K.P. Vetëm në 1 rast organi i akuzës vendosi mosfillimin e procedimit penal. Për 14 shtetas ose rreth 70% e rasteve, Prokurori i çështjes kërkoi caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Në 10 raste kjo masë siguri u la në fuqi nga ana e gjykatave të dy shkallëve të gjyqësorit. Ndërkohë masa e sigurimit arrest në shtëpi u kërkua nga ana e Prokurorit të çështjes në 3 raste, pozita procedurale e shtetasve u lehtësua nga ana e Gjykatave duke i lënë të lirë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, edhe pse këta shtetas rezultonin të bashkëpandehur me të tjerë pozita e të cilëve mbeti e pandryshuar.
6. Në 11 raste ose rreth 1.7% të numrit total të shtetasve të proceduar penalisht si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e drogëve, organi i akuzës ka proceduar shtetasit për më shumë se 1 figurë të veprës penale. Kryesisht figurat e veprave penale të cilat janë referuar nga ana e organit të akuzës janë të parashikuara nga nenet 283/1; 284; 333; 285/a ose 284 të Kodit Penal.
7. 27 shtetas, ndër të cilët në masë konstatohen shtetas të mitur, janë të njohur për efektivët e Policisë së Shtetit, për shkak të recidivizmit në kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave. Referuar këtij fenomeni në kontekstin e periodicitetit të kryerjes së veprave penale, me shqetësim ekspertët vërejnë se brenda një kohe të shkurtër rreth 1-2 mujore, shtetasit e proceduar një herë për veprën penale në fushën e drogërave rikthehen si përsëritës në kryerjen e kësaj veprë penale.

Sa i takon të dhënave të përmbledhura nën kategorinë e veprave penale të korrupsionit, të cilat analizohen me shembuj konkretë në kreun II, vlen të evidentohet se:

1. **281** shtetas janë proceduar penalisht për vepra penale të kategorizuara në fushën e korrupsionit, **70** prej të cilave ose rreth 25% nën kompetencën e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Nga këto 228 raste ose rreth 81% e numrit total i përkasin kualifikimit ligjor të parashikuar nga neni 248 K.P. “shpërdorim detyre”. Në vetëm **212** raste cilësimi juridik i shpërdorimit të detyrës është cilësuar “i pastër”, pra jo në konkurim me figura të tjera të veprave penale. Organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në **103** vendime ose rreth 49%, 25 prej të cilave kompetencë e SPAK, dhe pushimin e çështjes ose akuzës në 3 raste ose rreth 1% të rasteve, vendimmarrje të cilat nuk janë ankimuar nga ana e palëve në proces. Vetëm **49 shtetas** ose rreth 17.4% të rasteve janë arrestuar nga ana e efektivëve të policisë, në gjendje të flagrancës ose pas lëshimit të vendimeve gjyqësore ndaj tyre në mungesë.

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Në 9 raste krahas depozitimit të kërkesës për gjykim, organi i akuzës ka depozituar kërkesë për caktimin e masës së sigurimit personal. Ndaj 19 shtetasve ose rreth 39%, 14 prej të cilëve nën kompetencën e SPAK, organi procedues ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Procesi pranë Gjykatës së Apelit ka përfunduar për 15 prej këtyre shtetasve, 13 prej të cilëve të shqyrtuar nga SPAK, duke i lënë ata në ekzekutim të masës së sigurimit “arrest në burg”. Vetëm në 1 rast, Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit “arrest në burg” të kërkuar nga Prokurori dhe të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, duke e zëvendësuar me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shkak të rrethanave lehtësuese që karakterizojnë subjektin e veprës penale. Masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” rezulton të jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës ndaj 8 shtetasve ose rreth 16% të rasteve, 3 prej të cilëve janë hetuar, proceduar dhe shqyrtuar penalisht nga Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme (SPAK). Në 7 raste kjo masë siguri është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërkohë në vetëm 3 raste të cilat janë shqyrtuar nga SPAK vendimi ka marrë formë të prerë, pasi e njëjta masë siguri është vendosur edhe nga ana e Gjykatës së Apelit. Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në 14 raste ose rreth 5% të numrit total të shtetasve të proceduar, por në 13 raste 1 prej të cilave nën kompetencën juridiksionale të SPAK kjo masë është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërkohë vetëm në 1 rast Gjykata vendosi caktimin e masës ndaluese “pezullimi i ushtrimit të detyrës apo funksionit publik”. Organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “pezullimi i ushtrimit të detyrës apo funksionit publik” ndaj 4 rasteve, por vetëm në 1 rast procesi ka përfunduar në 2 shkallët e gjyqësorit duke lënë në fuqi kërkesën e Prokurorit. Në 2 raste ose rreth 1% të numrit total të procedimeve penale të regjistruara, rezulton se policia ka referuar në gjendje të lirë shtetasit e dyshuar. Në rreth 17.4% të rasteve ose 49 raste, konstatohet se shtetasit e akuzuar janë arrestuar nga ana e forcave të rendit, në kushtet e flagrancës ose nën ekzekutim të masave të sigurimit të dhëna ndaj tyre në mungesë nga ana e organit procedues.

2. **212** shtetas ose rreth 75% e numrit total të shtetasve rezultojnë të jenë referuar për procedim penal për figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 248 K.P. “Shpërdorim i detyrës”. Në **8** raste ose rreth 4% të kallëzimeve penale të depozituara rezulton se Prokurori i çështjes ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Në **7** raste kjo masë siguri e kërkuar nga ana e organit të akuzës është aprovuar nga përfaqësuesit e sistemit gjyqësor konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor, ndërkohë në 1 rast është vendosur ndryshimi i kësaj mase siguri në “arrest në shtëpi”. **Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e kërkuar nga prokurori për 5 shtetas, 2 prej të cilëve të gjinisë femërore, u aprovua nga ana e të dyja shkallëve të gjyqësorit, pra si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe nga ajo e Apelit. Favorizim jo i argumentuar sa i takon lehtësimit të pozitës proceduralo-penale konstatohet edhe ndaj 3 shtetasve, të cilët për shkak të funksioneve të tyre publike me veprimet/mosveprimet e tyre**

kishin lejuar dhe favorizuar kultivimin e lëndës narkotike cannabis sativa në juridiksionin territorial të Njesisë Administrative.

3. Në 44 raste ose rreth 15.6% e numrit total të procedimeve të regjistruara për veprat penale në fushën e korrupsionit rezulton se subjekte të denoncuar rezultojnë përfaqësues ose ish përfaqësues të sistemit të drejtësisë. Në 7 prej këtyre rasteve ose rreth 16%, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendimmarrje e cila nuk rezulton të jetë ankimuar nga ana e qytetarëve. 6 shtetas ose në rreth 2.1% e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në fushën e korrupsionit, të cilët rezultojnë shtetas të bashkëpandehur të përfshirë në skemën korruptive, me përshirjen e një gjyqtareje, avokatë, sekretarë gjyqësor, të burgosur dhe familjarë të tyre, rezulton se organi i akuzës ka cilësuar veprat penale nën nenin 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”; 319/a “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare” dhe 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”. Pozita procedurale e përfaqësueses së sistemit të drejtësisë, sekretares gjyqësore dhe avokatit nuk rezulton të jetë lehtësuar gjatë fazave të shqyrtimit të masës së sigurimit. Tjetër praktikë u ndoq nga ana e Prokurorisë për mjekun kirurg të përfshirë në përgjimet telefonike, ndaj të cilit për shkak të mungesës së rrezikshmërisë shoqërore nuk u ekzekutua masa e arrestit, por vetëm masa e pezullimiy nga detyra.
4. Në 89 raste ose rreth 42%, ekspertët nuk kanë mundur të grumbullojnë të dhëna të plota identifikuese në terren mbi ecurinë e hetimit , për shkak të sekretit hetimor që lidhet drejtpërdrejtë me subjektet aktive funksionarë publikë të dyshuar si të përfshirë ose mos ezaurimin e fazës së hetimeve paraprake.
5. Në përfundim të procesit zgjedhor, më 27 Prill 2021, SPAK njoftoi publikun se 33 procedime penale janë regjistruar në këtë institucion, të kategorizuara si vepra penale në fushën e zgjedhjeve, por për shkak të sensitivitetit të i karakterizon këto procedime dhe hetimet proaktive që po realizojnë organet proceduese, ekspertët e Qendrës Fol kanë mundur të grumbullojnë të dhëna vetëm për 7 raste të bëra publike përmes masave të shpallura nga gjykata . Ndaj 3 shtetasve, Prokuroria SPAK ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, masë e cila u la në fuqi edhe nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, në dy shkallët e gjykimit. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është kërkuar nga ana e Prokurorisë ndaj 2 shtetasve, të cilët kanë rënë në prangat e policisë pas informacioneve të përcjella në rrugë operative, masë e cila është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë (SPAK). Ndërkohë kallzimet e tjera nën monitorim janë në fazë të hetimeve paraprake nga ana e organit të akuzës dhe do të analizohen nga ana e ekspertëve të Qendrës Fol në raportet vijuese që do të hartohen.



Të dhënat e grumbulluara dhe të vlerësuara nëpërmjet raporteve të monitorimit në të gjithë ecurinë e procedimit që do të hartohen nga ana e ekspertëve të Qendrës Fol synojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve objekt monitorimi, si dhe kontribuimin modest në luftën ndaj parandalimit të këtyre fenomeneve që kanë prekur në masë shoqërinë shqiptare duke passjellë pasoja jo vetëm për subjektet e përfshira drejtpërdrejtë, por edhe për buxhetin e shtetit dhe publikun e gjerë.

Qendra “Fol” dëshiron të falenderojë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, institucionet kyçe që luajtën një rol të rëndësishëm në implementimin e iniciativës “Fol për Drejtësinë” si Policia e Shtetit, Prokuroritë pranë të dyja shkallëve të gjyqimit Tiranë dhe përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatave penale të të gjitha shkallëve të gjyqimit në Tiranë, si dhe ekspertët e angazhuar në terren në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.

KREU I

EFEKTIVITETI I LUFTËS KUNDËR BIMËVE DHE LËNDËVE NARKOTIKE

Lufta e shtetit shqiptar kundër bimëve dhe lëndëve narkotike e atyre psikotrope vijon prej dekadash, dhe tashmë është gjithëpranuar që ka pasur disa efekte.¹ Pavarësisht se Raporti i një viti më parë i Komisionit Europian lavdëroi zhvillimet progresive të realizuara, një ndër detyrat prioritare lënë Qeverisë Shqiptare për vitin vijues është “miratimi i një strategjie të re dhe plan-veprimi mbi drogërat, plotësimin e vakuimit ligjor mbi drogërat prekursorë, dhe intensifikimin e luftës kundër trafikut të drogërave”.² Duket sikur ditët e fundit Raporti i Europol ka tronditur sadopak klimën e qetë që karakterizonte përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse, sa i takon masave që po ndërmerren në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike. Nëpërmjet këtij Raporti, Europol ngre shqetësimin e kërcënimit serioz që i kanoset Bashkimit Europian nga influenca korruptuese dhe krimi i organizuar. Ndër të tjera citimi i Shqipërisë në këtë raport e identifikon vendin tonë si burimi kryesor i kanabisit bimor të trafikuar në BE.³

1. Çfarë përmbajnë të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara nga ekspertët e Qendrës Fol për një periudhë 6 mujore, në raport me subjektin “i mitur në konflikt me ligjin”?

Ekspertët e Qendrës Fol referuar të dhenave zyrtare dhe jo zyrtare për kategoritë e veprave nën monitorim kanë analizuar në mënyrë gjithëpërfshirë dhe në zbatim të një metodologjie të thelluar të dhënat që i korrespondojnë periudhës kohore Nëntor 2020 – Prill 2021.

Shqetësuese për ekspertët është numri i lartë i shtetasve të proceduar penalisht për figurat e veprave penale të përfshira në kategorinë e drogës, më konkretisht gjatë kësaj periudhe 6 mujore **640 shtetas rezultojnë të proceduar në qarkun Tiranë. 16 prej këtyre shtetasve ose rreth 2.5% e numrit total janë shtetas të mitur, pra nën moshën 18 vjeç. Nga ana e organeve proceduese këto shtetas janë**

¹ Link referues: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

² Raport Shqipëria 2020, fq. 38. Link: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

³ Link referues: <https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/european-union-serious-and-organised-crime-threat-assessment>

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

referuar në gjendje të lirë. Për 11 prej tyre, në përfundim të hetimeve paraprake Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që këto vendimmarrje të organit të akuzës nuk janë ankimuar dhe nuk janë bërë pjesë e rishqyrtimit gjyqësor. Referuar kësaj periudhe gjatë të cilës konstatohet një numër më i lartë i shtetasve të mitur të përfshirë, vlen të sjellim në vëmendje se nga 16 të mitur të proceduar, procedimi penal për 10 prej tyre (ose rreth 65%) është regjistruar në 4 mujorin e parë të vitit 2021, ndërsa 6 të mitur (rreth 35%) janë proceduar gjatë 2 mujorit të fundit të vitit 2020.

3 elementë vlerësohen si cilësues metodologjikë nga analiza e praktikës dokumentative që është realizuar nga ana e ekspertëve të Qendrës Fol. Më konkretisht:

- ✚ 12 të mitur (ose rreth 71%) janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 K.P., në formën e prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike. 4 shtetas të mitur (ose rreth 24%) janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 283 K.P., në formën e “shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit, dorëzimit, si dhe mbajtjes”. Vetëm 1 shtetas është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale të “nxitjes për përdorimin e drogës” të parashikuar nga neni 286 K.P., por në këtë rast subjekti viktimë i veprës penale ka qenë i mitur. Nga të dhënat rezulton se shtetasi i proceduar penalisht pasi ka abuzuar seksualisht me të miturën në një fshat të Ersekës, e ka detyruar për të konsumuar lëndë narkotike të llojit kokainë dhe kanabis. Autori i dyshuar i kësaj vepre penale është proceduar edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 101 K.P. “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”. Gjykatat e zakonshme të të dyja shkallëve të gjyqimit kanë lënë në fuqi masën e sigurimit “arrest në burg” të kërkuar nga ana e prokurorit të çështjes.
- ✚ Shtetasit e mitur të proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë së Shtetit janë përdorues prej vitesh të lëndës narkotike, si rrjedhojë mbajtja e sasisë së substancës apo të lëndës narkotike për përdorim vetjak ose në doza të vogla sipas kritereve të parashikuara në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008., ka shërbyer si lehtësim dhe si bazueshmërië për vendimmarrjen e organit të Policisë apo të prokurorisë. Mënyra e kryerjes së veprës penale nga ana e shtetasve të mitur nuk ka qenë e sofistikuar, përveç një rasti kur i mituri në shoqërinë e 3 miqve të tij kishte fshehur lëndën narkotike në mbajtësen e syzeve.
- ✚ Lloji i substancës apo lëndës narkotike të poseduar nga ana e të miturve të kapur dhe të referuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit rezulton në vend të parë kanabis dhe në një rast të shkëputur ekstazi. Referuar vendndodhjes në të cilën janë lokalizuar këta shtetas nga patrullat e policisë konstatohen si *hotspot* (“pika të nxehta”) të kryeqytetit Rr.

Riza Cuka (e quajtur katrori); Rr. Stavri Themeli (afër ish Parkut); Rr. Ibrahim Rugova (Paskuqan); Yzberisht; Rr. Egnatia (Don Bosko); Rr. Baftjar Liçi (zona e Dajtit) dhe Zona e ish-Parkut (afër Bar Shqiponja).

1.1. Trendi i kryerjes së kësaj vepre penale gjatë 2 mujorit të fundit të vitit 2020 dhe 4 mujorit të parë të vitit 2021




Nga të dhënat e grumbulluara rezultojnë se nga 640 shtetas të proceduar penalisht për kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave, **gjatë 2 mujorit të fundit të vitit 2020 rreth 231 shtetas janë kualifikuar si autorë të dyshuar, duke përbërë rreth 36% të numrit total të shtetasve. Ndërkohë gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2021 konstatohet një trend në rritje e procedimit të shtetasve për këtë kategori,**

ekzaktësisht rreth 409 shtetas ose rreth 64%. Por në 4 mujorin e parë të vitit 2021 bie në sy një trend përkatësisht linear dhe pa shumë diferencë, duke mbajtur të njëjtën dinamikë si fundi i vitit 2020.

Nëpërmjet këtij raporti studimor ekspertët kanë zgjedhur të paraqesin në formë reale datën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht regjistrimit të procedimit penal në regjistrimin e kallëzimeve/referimit të veprave penale. Për rrjedhojë duhet mbajtur parasysh se disa nga veprat penale të regjistruara në muajin Janar 2021 kanë ndodhur në muajin Dhjetor 2020. Pavarësisht kësaj metodologjie, ekspertët zgjedhin të reflektojnë të dhëna lidhur me trendin e kryerjes së veprës penale mbi baza mujore.

1.2. Figurat e veprave penale të konsumuara në fushën e drogërave

1.2.1. Shtetas të konstatuar për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike sipas nenit 283



Të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283 K.P., rezultojnë 442 shtetas ose rreth 69% e numrit total të shtetasve të proceduar për të gjitha figurat e veprave penale në fushën e drogërave. 157 prej këtyre shtetasve ose rreth 36% e kategorisë së sipërcituar rezultojnë të proceduar

penalisht gjatë vitit 2020, ndërsa gjatë vitit 2021 rezultojnë 285 shtetas ose rreth 64%.

1.2.1.1. A është politika penale në favor të shtetasve të proceduar në gjendje të lirë?

Referuar politikës penale të zbatuar nga ana e organeve proceduese rezulton se rreth 326 shtetas ose rreth 74% e numrit total të shtetasve të proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike për këtë dispozitë janë proceduar në gjendje të lirë. Për 232 prej tyre ose rreth 71% e numrit total të shtetasve të proceduar në gjendje të lirë, organi i akuzës brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 290 K.Pr.Penale. Nga 232 raste vetëm në 1 rast konstatohet se Gjykata ka ndryshuar vendimmarrjen e Prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, për shkak të ankimit të depozituar. Fillimisht shtetasi u referua për procedim në gjendje të lirë. Mjeti i braktisur i cili i përkiste të dyshuarit iu nënshtrua ekzaminimit, ndërkohë që në kroskot dhe në bagazh u gjet një sasi e lëndës narkotike cannabis sativa. I dyshuari rezultonte përdorues prej shumë vitesh i lëndës narkotike, ndërkohë që deklaronte se *“e kam blerë nga një i panjohur për përdorim vetjak”*. Pavarësisht vendimmarrjes së organit procedues, gjyqtari kompetent për shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë hetimeve paraprake vendosi rifillimin e hetimeve, në përfundim të të cilave u caktua masa e sigurimit “arrest në burg” ndaj të dyshuarit.

Vetëm ndaj 2 shtetasve organi i akuzës, në përfundim të fazës së hetimeve paraprake vendosi pushimin e akuzës ose të çështjes penale. Të dy këta shtetas rezultojnë të referuar në gjendje të lirë nga ana e Policisë së Shtetit, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike. Të dy shtetasit rezultojnë përdorues të lëndës narkotike prej vitesh, ndërkohë njëra prej shtetasve rezulton e gjinisë femërore, e cila në momentin e kontrollit nga forcat e policisë ka deklaruar se *“materiali është sodë buke”*, por pas ekzaminimeve ka rezultuar lëndë narkotike e llojit kokainë.

Pas përfundimit të hetimeve paraprake për shtetasit e proceduar në gjendje të lirë në 5 raste, Prokurori i çështjes depozitoi kërkesë për gjykim duke ia besuar vijueshmërinë e procesit penal sistemit gjyqësor, por vetëm në 1 rast përfaqësuesi i organit të akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”. Kjo kërkesë u aprovua nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, për shkak se llojet ekstazi, LCD dhe cannabis sativa, si dhe sasia e lëndës narkotike të gjetur gjatë kontrollit në banesën e shtetasit të pandehur rezultonte e madhe. Ndërkohë në 1 rast, Prokurori i çështjes kërkoi caktimin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila u aprovua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast, shtetasi u arrestua në zonën e Astirit, ndërkohë që gjatë kontrollit fizik u gjetën 234 doza cannabis sativa të përgatitura për shitje. Në 3 rastet e tjera objekt studimi vërehet se përfaqësuesi i organit të akuzës krahas depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal sipas nenit 234 K.Pr.P. “detyrimi për t’u paraqitur pranë policisë gjyqësore”. Kjo masë siguri e kërkuar nga ana e prokurorit, u caktua dhe nga ana e përfaqësuesit të sistemit gjyqësor. Të 3 këta shtetas u arrestuan fillimisht nga ana e forcave të policisë, ndërkohë që gjatë kontrollit iu gjet

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

lënda narkotike e llojit cannabis sativa. 2 prej këtyre shtetasve gjithashtu u proceduan për veprën penale të drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 K.P.

1.2.1.2. Numër i ulët i shtetasve të arrestuar në flagrancë si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike

98 shtetas ose rreth 22% e numrit total të shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 K.P., janë arrestuar në flagrancë nga ana e forcave të Policisë së Shtetit në pika kyçe të kryeqytetit. 1 prej shtetasve u arrestua për shkak se gjatë kontrollit fizik të automjetit në pronësinë e tij u gjet lëndë narkotike në masën 0.7 gram kokainë, por duke qenë se kjo masë u cilësua për përdorim vetjak, organi i akuzës vendosi mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që për drejtimin e mjetit në gjendje të dehur prokurori kërkoi caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kjo kërkesë e prokurorit u aprovua nga ana e Gjykatës.



Por si rezultojnë masat e sigurimit të kërkuara nga ana e organit të akuzës dhe qasja e sistemit gjyqësor ndaj kërkesave të Prokurorisë? Nga të dhënat konstatohet se prirja e organit të akuzës konsiston drejt depozitimit në një masë më të madhe të kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Koncretisht në 45 raste, ose në rreth 46% e numrit total të shtetasve të arrestuar në flagrancë, organi i akuzës ka kërkuar caktimin

e masës së sigurimit “arrest në burg”. Ndërkohë në 42 raste ose rreth 43% konstatohet depozitimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kryesisht shtetasit ndaj të cilëve është kërkuar caktimi i kësaj mase sigurimi janë përdorues prej shumë viteve të lëndës narkotike ose shpërndarës të saj. 4 prej këtyre shtetasve të arrestuar në flagrancë kanë rezultuar dhe mbajtës të armëve të ftohta. Interesant paraqitet rasti i një shtetasi të mitur 16 vjeçar, i cili është arrestuar ndërkohë që drejtonte automjetin pa qenë i pajisur me leje drejtimi. Gjatë kontrollit fizik është konstatuar mbajtës i disa dozave hashashi, ndërkohë që gjatë kontrollit në banesën e tij është gjetur dhe një armë në dukje lodër, por pas ekzaminimeve ka rezultuar armë e mirëfilltë zjarri, duke bërë që i mituri të procedohej edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 278 K.P. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”.


5 shtetas u arrestuan nga ana e Policisë së Shtetit si të dyshuar pasi kishin përshtatur lokalitë e njërit prej të dyshuarve për përdorim droge. Në tejkallim të fashës orare, qytetarët informuan Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Policinë mbi vijimin e veprimtarisë së këtij lokali, situatë e cila detyroi forcat e rendit të ushtronin kontrollin në mjediset e brendshme të lokalit, tek i cili gjetën cannabis sativa dhe kokainë si dhe një peshore elektronike.

Ndaj 7 shtetasve ose rreth 7% Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi”. Kjo masë sigurimi e kërkuar nga ana e organit të akuzës në të gjitha rastet është aprovuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kryesisht lëndë narkotike është gjetur nën posedimin e këtyre shtetasve, gjatë kontrollit fizik që iu është ushtruar në automjetet ose banesat e tyre. Ndërkohë për 4 shtetas të tjerë rezultoi se organi i akuzës ende nuk ka një vendim konkret, për shkak se këto vepra penale janë regjistruar në ditët e fundit të grumbullimit të të dhënave për studimin dhe fati i procedimit penal përcaktohet nga rezultati i testeve toksikologjike që realizohen pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.

1.3. Shtetasit e dyshuar si autorë të mbajtjes, shitjes ose shpërndarjes së lëndës narkotike, referuar nenit 283/1 K.P.

141 shtetas ose rreth 22% e numrit total të shtetasve të referuar si autorë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave, rezultojnë të jenë proceduar penalisht si të dyshuar për mbajtjen, shitjen ose shpërndarjen e lëndës narkotike sipas nenit 283/1 K.P.



89 shtetas ose rreth 63% e numrit total të shtetasve të proceduar penalisht gjatë 6 muajve, janë proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë së Shtetit. Këta shtetas rezultojnë përdorues të lëndës narkotike, recidivistë në kryerjen e veprave penale në fushën e drogës dhe posedues të një sasive të vogël të lëndës narkotike për përdorim vetjak.

Ndaj 65 shtetasve të proceduar në gjendje të lirë për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 K.P. ose rreth 73% e numrit total të shtetasve të proceduar, rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në asnjë rast vendimmarrja e Prokurorisë nuk është ankimuar. Shtetasit rezultojnë mbajtës të lëndës narkotike hashash, të një sasive të vogël për përdorim vetjak, ndërkohë që lokacionet në të cilat u konstatuan nga ana e forcave të rendit janë: Fusha e Aviacionit, Rr. Panorama e Liqenit, Rr. Njazi Meka (zona Allias), Don Bosko, Rr. Grigor Heba (pranë Stadiumit Dinamo) etj.

Vetëm në 1 rast pasi forcat Shqiponja arrestuan një shtetas që udhëtonte në automjet me 2 shtetas, përfaqësuesi i organit të akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit arrest në burg ndaj këtij shtetasi, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor vendosi caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në

policinë gjyqësore”. Nisur nga rrethanat e faktit konstatohet se sasia e lëndës narkotike gjetur shtetasit ka qenë e një mase të vogël, ndërkohë që shtetasi është referuar edhe si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të moskallëzimit të krimit.

1.3.1. Masat e sigurimit kërkuar nga Prokurori ndaj shtetasve të dyshuar për mbajtjen, prodhimin ose shitjen e lëndës narkotike

Nga 141 shtetas të proceduar penalisht, vetëm 43 prej tyre ose rreth 30% e rasteve rezultojnë të jenë arrestuar nga ana e forcave të rendit.



Për 17 shtetas ose rreth 12% e numrit total të shtetasve të proceduar penalisht, organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Në 10 raste kjo masë siguri e kërkuar nga ana e prokurorit, u aprovua nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që shqyrtimi në Apel duke lënë në fuqi këtë masë u përfundua vetëm në 4 raste, deri në momentin e vlerësimit të të dhënave nga ana e ekspertëve. Në 1 rast autorit të dyshuar gjatë kontrollit në banesën e tij iu gjetën një peshore

elektronike dhe sasi e konsiderueshme e lëndës narkotike dhe vlera monetare. Ky shtetas është arrestuar nga ana e forcave të policisë jashtë banesës së tij ndërkohë që duhej të ishte nën ekzekutim të masës së sigurimit arrest në shtëpi dhënë ndaj tij, si person nën hetim për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Ndërkohë në një tjetër rast, i dyshuari pretendoi se lënda narkotike e gjetur nuk i përkiste atij, por ngjarja manipulohet nga persona të caktuar brenda radhëve të Policisë së Shtetit, por këto pretendime nuk u morën parasysh nga ana e përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë duke i dhënë prevalencë rrethanave faktike.

Vetëm në 2 raste organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila u aprovua nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë në njërin prej rasteve, vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit u la në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Apelit.

25 shtetasit ndaj të cilëve Prokurori kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 K.Pr.P., rezulton se u lanë nën ekzekutimin e kësaj mase siguri edhe nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor. Vetëm në 1 rast shtetasi sirian apeloj masën e sigurimit pranë Gjykatës së Apelit, por ende nuk ka një vendimmarrje mbi këtë çështje. Kryesisht lënda narkotike e cila iu gjet këtyre shtetasve ishte e llojit cannabis sativa

ose kokainë, ndërkohë që shtetasit e dyshuar rezultojnë përdorues të lëndës narkotike, si rrjedhojë sasia e lëndës narkotike reflektohet e përshtatshme për përdorim vetjak. Në 2 raste policia referoi se arrestimi i shtetasve është realizuar edhe për faktin se kanë drejtuar mjetin në gjendje të parregullt, duke bërë që ata të procedohen penalisht edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 291 K.P.

1.4. Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotikë në rrethana cilësuese dhe përshtatja e lokalit për përdorim droge

20 shtetas ose rreth 3.1% e numrit total janë proceduar penalisht si të dyshuar për prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike në rrethana cilësuese. Në 2 prej këtyre rasteve është konstatuar konkurrimi i kësaj vepre penale me nenet 285/a “përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe 283 “prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”.

Interesant shfaqet rasti i njërit prej shtetasve, ndaj të cilit organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila u aprovua nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor në dy shkallët e gjyqimit. Gjatë procesit gjyqësor avokati mbrojtës referoi se i pandehuri është përdorues i lëndës narkotike, me arsim të lartë si dhe i punësuar IT. Por pavarësisht këtyre referimeve të karakterit lehtësues, nuk kanë shërbyer si pretendime justifikuese përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për sistemin gjyqësor.

1.5. Trafikimi i lëndëve narkotike dhe krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës

5 shtetas janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a dhe 283/b të Kodit Penal. Prej këtyre 3 shtetas rezultojnë të dyshuar për trafikimin e lëndëve narkotike. Të 3 këta shtetas rezultojnë pjesë e procedimit penal të regjistruar në kuadër të operacionit “Lugina”, ku shtetasit e dyshuar kanë hedhur në tokë 2 çanta shpine, brenda të cilave kishte një sasi prej 10 kg lëndë të dyshuar kanabis, të cilën po tentonin ta trafikonin në drejtim të Greqisë. Masa e sigurimit e kërkuar nga ana e organit të akuzës për këta shtetas është ajo e arrestit në burg, e cila u caktua edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por në rastin e njërit prej shtetasve të dyshuar masa e sigurimit u caktua me afat 40 ditore, me synim paraqitjen e provave shtesë nga ana e Prokurorisë.

Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës, parashikuar nga neni 283/b K.P. u referua për 2 raste, një nga të cilat shtetase e gjinisë femërore e cila u referua në gjendje të lirë nga ana e Policisë, ndërkohë që organi i akuzës vendosi mosfillimin e procedimit penal. Ndërkohë për rastin e dytë, prokurori kërkoi caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për një shtetas i cili dyshohej se kishte përshtatur lokalitetin e tij për qëllime të konsumit të

lëndës narkotike, pasi gjatë kontrollit fizik u gjetën mjete që përdoren për marrjen dhe përdorimin e drogës.

1.6. Shtetasit e dyshuar si kultivues të bimës narkotike

20 shtetas rezultojnë se janë proceduar penalisht si të dyshuar për kultivimin e bimës narkotike, të parashikuar nga neni 284 K.P. Vetëm në 1 rast organi i akuzës vendosi mosfillimin e procedimit penal, për shkak se dyshimet se shtetasi siguronte farën e drogës të cilën donte ta mbillte në fshatrat Kasharaq, Mazrek dhe Kus, rezultuan të paprovuara.



Për 14 shtetas ose rreth 70% e rasteve, Prokurori i çështjes kërkoi caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Në 10 raste kjo masë siguri u la në fuqi nga ana e gjykatave të dy shkallëve të gjykimit. Ndër këto raste përfshihen 8 shtetas nën hetim për operacionin e sipërcituar të hetuar dhe proceduar nga SPAK, si dhe 2 shtetas nën hetim pas ndërmarrjes së operacionit “Gomeni”. Gjatë këtij operacioni u vendosën nën hetim 14 persona, por vetëm ndaj 8 prej tyre u ekzekutua arresti në flagrancë. Pavarësisht se të

dyshuarit mohojnë përfshirjen në veprën penale, u konstatua se pozita e tyre procedurale u lehtësua nga faza në fazë e procedimit, duke reflektuar një qasje lehtësuese nga përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë.

Ndërkohë masa e sigurimit arrest në shtëpi u kërkua nga ana e Prokurorit të çështjes në 3 raste, shtetasit e përfshirë në operacionin Gomeni, pozita procedurale e të cilëve u lehtësua edhe nga ana e Gjykatave të dy shkallëve të gjykimit, me arsyetimin se gjykatat nuk mund të caktojnë një masë më të rëndë se ajo e kërkuar nga ana e prokurorit.

Ndërsa masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” u kërkua nga ana e Prokurorit, dhe u caktua nga ana e dy shkallëve të gjykimit për dy gjykatat e posaçme (SPAK) për 2 shtetas të dyshuar si të përfshirë në materialin e sipërcituar të referuar nga ana e SHÇBA, për operacionin e ndërmarrë në Njësinë Administrative Tërpan (Skrapar).

1.7. Konkurrimi i disa veprave penale

Në 11 raste ose rreth 1.7% të numrit total të shtetasve të proceduar penalisht si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e drogave, organi i akuzës ka proceduar shtetasit për më shumë se 1



figurë të veprës penale. Kryesisht figurat e veprave penale të cilat janë referuar nga ana e organit të akuzës janë të parashikuara nga nenet 283/1; 284; 333; 285/a ose 284 të Kodit Penal.

Në 7 raste rezulton që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) mbi bazën e referimit nga ana e Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat (SHÇBA) në Ministrinë e Brendshme, ka regjistruar procedimin penal ndaj administratorit të Njësisë Administrative Tërpan, i cili në bashkëpunim me kryeplakun e fshatit Çorrogjaf kanë lejuar kultivimin e bimëve narkotike në territorin ku ushtrojnë detyrat funksionale dhe kompetencat, si dhe kanë favorizuar autorët që kanë kryer kultivimin e bimëve narkotike. Nga hetimet e realizuara dhe nga mjetet e përdorura për kërkimin e provës, ka rezultuar se në parcela të ndryshme të kësaj zone të Skraparit janë kultivuar sasi të konsiderueshme të bimës narkotike cannabis sativa, ndërkohë që infrastruktura e ngritur për mirëmbajtjen e këtyre parcelave rezultonte e sofistikuar, duke krijuar dyshime për prani të elementëve të grupit të strukturuar kriminal. Gjatë këtij operacioni të ndërmarrë janë sekuestruar gjithsej 5045 bimë narkotike të llojit “cannabis sativa”, si dhe janë sekuestruar 176 kg lëndë narkotike e paketuar në qese. Ky rezulton një operacion i suksesshëm i forcave të rendit, i cili solli arrestimin e 23 shtetasve, ndër të cilët funksionarë publikë. Ndaj 6 shtetasve organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor të dy shkallëve të gjykimit (pranë Gjykatës së Posaçme). Ndërkohë në rastin e 1 shtetaseje të gjinisë femërore, pjesë e të njëjtit procedim penal, organi i akuzës dhe Gjykata e Posaçme në të dyja shkallët e gjykimit ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi”.

2 raste u referuan nga ana e specialistëve të seksionit për krimet e narkotikëve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Njëri prej rasteve ishte suksesi i kurorëzuar “Lugina” pas bashkëpunimit me Policinë Kufitare Kapshticë, SHÇBA Korçë dhe shërbimeve të Frontex-it, si rezultat i të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i një shtetasi me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, posedues i lëndëve narkotike dhe armëve luftarake e municionit.

Ndërkohë 2 shtetas të arrestuar në flagrancë nga ana e policisë, në ambiente me prezencë edhe të personave të tjerë, u konstatuan mbajtës të lëndës narkotike cannabis sativa dhe kokainë. Për shkak të rrethanave në të cilat u krye vepra penale, në njërin prej rasteve u arrestuan 11 persona, ndërkohë që procedimi penal u nda ndërmjet shtetasve të pandehur, për shkak se 1 prej të arrestuarve ishte kapur nën posedim të një sasive jo të vogël të lëndës narkotike kokainë, të ndarë në paketime.

1.8. Fenomeni i recidivizmit dhe përfshirja e subjekteve të gjinisë femërore si autore të dyshuara të veprave penale në kategorinë e drogërave


Nga të dhënat e grumbulluara nga ekspertët e qendrës Fol konstatohet se 27 shtetas janë eksponentë të njohur për efektivet e Policisë së Shtetit, për shkak të recidivizmit në kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave. Referuar këtij fenomeni në kontekstin e periodicitetit të kryerjes së veprave penale, me

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

shqetësim ekspertët vërejnë se **brenda një kohe të shkurtër rreth 1-2 mujore**, shtetasit e proceduar një herë për veprën penale në fushën e drogërave rikthehen si përsëritës në kryerjen e kësaj vepre penale. **Në këndvështrimin e ekspertëve një periodicitet i tillë është ndikues në politikën penale që zbatohet nga ana e përfaqësuesve të mekanizmit të sistemit të drejtësisë, ndërkohë që rehabilitimi dhe parandalimi nën këto rrethana nuk tregojnë se ka efektin e duhur.**

Organi i akuzës në pjesën më të madhe të rasteve konstatohet se ka vendosur mosfillimin e çështjes ose të procedimit penal, bazuar në argumentimin se sasia e lëndës narkotike e poseduar nga këta shtetas ka qenë e një sasive të vogël proporcionale për përdorim vetjak, me sasira që variojnë kryesisht nga 0.2 gramë deri në 0.5 gramë , ndërkohë që këta shtetas vetdeklarohen.

Vetëm në një rast organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, masë e cila është aprovuar nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me pretendimin se argumentimi i shtetasit se është përdorues i lëndës narkotike nuk është relevant pasi sasia e lëndës narkotike e gjetur është e madhe, ndërkohë që shtetasi është arrestuar në cënim të një tjetër mase sigurimi “arrest në shtëpi” (larg vendqëndrimit të tij të deklaruar) dhënë ndaj tij për një tjetër vepër penale të kryer në fushën e drogërave.



Sa i përket analizës së të dhënave referuar aspektit gjinor, konstatohet përfshirje e rreth 16 femrave, ose rreth 2.5% e numrit total të shtetasve të proceduar penalisht për kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave. Vepra penale për të cilën rezultojnë të jenë referuar në masë këto shtetase është “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 K.P. **Në 5 prej këtyre rasteve organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendimmarrje e cila nuk është ankimuar, ndërkohë për 1 shtetase është vendosur pushimi i çështjes ose i akuzës për shkakun se masa e lëndës narkotike ka qenë e vogël, e përdorshme për përdorim vetjak për shtetasen e cila rezultoi përdoruese prej vitesh e lëndës narkotike.**



KREU II

FORMAT E KORRUPSIONIT DHE SHPËRDORIMI I DETYRËS

1. Shifra të larta të procedimeve penale ndaj subjekteve të dyshuar si autorë të veprave penale në kategorinë e korrupsionit

Vendi ynë sapo ka mbyllur procesin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021 . Raporti i Parlamentit Europian vlerësoi implementimin e një reforme të rëndësishme në sistemin gjyqësor, të pasuar nga një proces rivlerësimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve të paprecedentë dhe ngritjen e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të posaçme të drejtësisë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (të ashtuquajtura Byroja Kombëtare e Hetimit – BKH dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK), por një fenomen i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme është intensifikimi i luftës ndaj korrupsionit kryesisht të zyrtarëve publikë. Përmirësimi i

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

vendit tonë është vënë në dukje edhe nga ana e Transparency International gjatë vitit 2020, duke e rënditur të 111-tën në listë Shqipërinë.⁴

Ekspertët e Qendrës FOL nga të dhënat e grumbulluara në terren gjatë një periudhe 6 mujore konstatojnë se shifrat nuk janë shqetësuese, në raport me kategorinë e veprave penale të përfshira në fushën e drogërave, të trajtuar në kreun paraardhës. **Shqetësimi kyç i ekspertëve në analizën e të dhënave konsiston në subjektet e përfshira në aktet e dyshuara si veprime korruptive, të cilat pasqyrojnë një numër të lartë të shtetasve që mbajnë funksione publike, ndër të cilët dhe përfaqësues apo ish funksionarë të sistemit të drejtësisë penale, avokatë, ekspertë, gjyqtarë apo prokurorë. Vendimet e mosfillimit dhe pushimit të çështjeve penale të ngritura në ngarkim të këtyre subjekteve, mbi bazën e kallëzimeve të qytetarëve, nuk rezultojnë të jenë ankimuar nga këta të fundit, duke reflektuar një mungesë të besimit në gjetjen e drejtësisë efëcente.**

281 shtetas janë proceduar penalisht për vepra penale të kategorizuara në fushën e korrupsionit.



Pjesa më e madhe e shtetasve rezultojnë të jetë proceduar në vitin 2021, konkretisht **208** shtetas ose rreth 74%. Kjo shifër mbetet e mirëkuptueshme gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2021, ndërkohë që një sërë çështjesh që kanë tërhequr vëmendjen e publikut kanë ndodhur. Ndërkohë në 2 mujorin e fundit të vitit 2020, 73 shtetas ose rreth 26%.

Numri i procedimeve penale të regjistruara mbi baza mujore pasqyron një trend të

ngjashëm të kryerjes së veprave penale në fushën e korrupsionit, nga ana e autorëve të dyshuar. Në muajin Shkurt 2021 rezultojnë që **61** shtetas janë proceduar penalisht, duke përbërë rreth 29% të numrit total të shtetasve të proceduar për vitin 2021.

Subjektet fizike ose përfaqësuesit e entiteteve publike si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e korrupsionit

⁴ <https://europeanwesternbalkans.com/2021/02/04/transparency-international-corruption-is-on-the-rise-in-the-western-balkans/>

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Përfaqësues të institucioneve publike si Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë rajonale, agjensi të posaçme pranë Ministrive të linjës, ARRSH (Autoriteti Rrugor Shqiptar), OSHEE (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), punonjësit e institucioneve të ndryshme të sistemit penitenciar (burgjeve) etj., si dhe përfaqësues të subjekteve private si banka të nivelit të dytë dhe fondacione mikrofinanciare, rezultojnë të kallëzuar nga ana e shtetasve të ndryshëm fizikë si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e korrupsionit.

Të dhënat e reflektuara në formë grafike janë të përgjithshme, ndërkohë që në mënyrë specifike kategorizimi i rasteve do të realizohet edhe referuar figurës së veprës penale që dyshohet se është kryer. Për shkak të rëndësisë, ekspertët do të paraqesin me informacione të detajuara kallëzimet e referuara ndaj ish përfaqësuesve apo përfaqësuesve aktualë të sistemit të drejtësisë.



Në analizë të këtyre të dhënave makro, ekspertët konstatojnë se qytetarët I janë drejtuar prokurorisë me kallzime ndaj përfaqësuesve të drejtorive përgjegjëse dhe ministrive të linjës. Ndërkohë numrin më të ulët të procedimeve penale e konstatojmë në rastin e figurave të veprave penale në fushën e korrupsionit, të cilat dyshohet se mund të jenë kryer nga ana e përfaqësuesve të Njësive Administrative në nivel

vendor.

2. Statusi procedural i shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kategorinë “Korrupsion”

Në 2 raste ose rreth 1% të numrit total të procedimeve penale të regjistruara, rezulton se policia ka referuar në gjendje të lirë shtetasit e dyshuar. Një rast interesant është rrjedhja e gazit në shkollën Qatar College. Për shkak se disa fëmijëve iu rrezikua jeta u regjistrua procedimi penal ndaj rojes dhe inxhinierit. Krahas kallëzimit për shpërdorim detyre, u pretendua dhe shkelje e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive, vepër penale e parashikuar nga neni 282 K.P.


Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Në rreth 17.4% të rasteve ose 49 raste, konstatohet se shtetasit e akuzuar janë arrestuar nga ana e forcave të rendit, në kushtet e flagrancës ose nën ekzekutim të masave të sigurimit të dhëna ndaj tyre në mungesë nga ana e organit procedues. Një oficer i Policisë Rrugore depozitoi kallëzim ndaj një qytetari, i cili i ndaluar në gjendje të dehur dhe në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor tentoi të korruptonte me një shumë monetare prej 10 Euro forcat e rendit. Kjo çështje u shqyrtua nga ana e SPAK, ndërkohë që si organi procedues edhe Gjykata e Posaçme mbajtën qëndrimin se ndaj këtij shtetasi masa e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” do të jepte efektin e kërkuar parandalues të politikës penale. Duke pranuar fajësinë dhe duke shfaqur pendesë për veprimin e kërkuar, qytetari duke kërkuar shqyrtimin e procesit gjyqësor me gjykim të shkurtuar u dënua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë me 9 muaj burgim. Për shkak të procedurës së posaçme të gjykimit të shkurtuar dhe reduktimit të dënimit në 6 muaj burgim, Gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për 12 muaj, sipas nenit 59 K.P.

2 inspektorë të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) ranë në prangat e Policisë, për shkak se në zonën e Kamzës kanë kërkuar shuma të konsiderueshme monetare nga ana e qytetarëve, me qëllim mosndëshkimin e tyre për shkak të ndërtimeve të paligjshme. Pas kryerjes së një hetimi intensiv nga SPAK, këta shtetas u arrestuan në mungesë, ndërkohë që masa e sigurimit “arrest në burg” e kërkuar nga ana e Prokurorit të çështjes, u la në fuqi në të dyja shkallët e gjykimit.

3. Figura e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”

Në strategjinë e saj “Lufta kundër Korrupsionit për të Përmirësuar Qeverisjen” (1998), Programi i Zhvillimit të OKB-së e përkufizon korrupsionin si “shpërdorim i detyrës së pushtetit publik ose autoritetit për përfitime private - nëpërmjet mitës, shpërdorimit të detyrës, tregtimit të influencës, nepotizmit, mashtrimit, parave për përshpejtim ose abuzimit me fondet. **212 shtetas ose rreth 75% e numrit total të shtetasve rezultojnë të jenë referuar për procedim penal për figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 248 K.P. “Shpërdorim i detyrës”.**



Referuar kategorizimit mbi bazën e kryerjes së kësaj vepre penale në periudha konkrete kohore rezulton se 73% ose rreth 155 procedime penale janë regjistruar në vitin 2021, ndërkohë 57 shtetas ose rreth 27% janë referuar në vitin 2020. Muaji Shkurt 2021 referohet si muaji me regjistrimin më të lartë të procedimeve penale, konkretisht 45 shtetas ose rreth 29% e

numrit total të procedimeve për vitin 2021. Ndërkohë muaji pasues, Mars 2021 është regjistruar

si muaji me numrin më të ulët të procedimeve penale të regjistruara, përkatësisht 31 shtetas ose rreth 20%.

3.1. Një çështje pikante ...

Ekspertët e Qendrës Fol kanë përzgjedhur disa nga çështjet më pikante, për të cilat konstatohet se ndërmjet përfaqësuesve të mekanizmit të sistemit të drejtësisë (pra trekëndëshi Polici – Prokurori – Gjykatë) ka pasur qëndrime të ndryshme, në disa raste kontradiktore. Disa prej çështjeve të reflektuara në këtë studim, në respektim të sekretit hetimor nuk do të reflektohen me të dhëna të individualizuara dhe identifikuese të subjekteve apo të rrethanave të plota faktike, për shkak se sistemi gjyqësor ende nuk është shprehur për pjesën më të madhe të tyre.

Greva e parë e padeklaruar në sektorin publik në gati 2 dekada ishte kryefjala e lajmeve mediatike në javën e parë të muajit Prill 2021.⁵ Me urdhër të prokurorisë, forcat e rendit ekzekutuan vendimmarrjet për ndalimin e 3 shtetasve, kontrollorë me cilësi të veçanta profesionale. Sipas kallëzimit të depozituar nga AlbControl, këta shtetas dyshohen se nxitën 31 kontrollorë të tjerë që të përfshihen në grevë dhe të bllokojnë fluturimet në linjat ajrore të aeroportit të Rinasit. Reduktim i pagës dhe mos suksesi i negociatave dyshohet se cënuan interesin ekonomik të subjektit punëdhënës, por edhe interesin publik. Vetëm ndaj njëres prej shtetasve të gjinisë femërore, organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, ndërkohë që ndaj 2 kolegëve të saj u kërkua të caktohej masa “arrest në burg”. Masa e sigurimit e dhënë ndaj kësaj shtetaseje u lehtësua proceduralisht gjatë shqyrtimit gjyqësor, për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë aprovoi kërkesën e depozituar nga prokurori ndërsa Gjykata e Apelit vendosi “detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, me argumentimin se e pandehura është nënë e një fëmije të mitur. Gjithashtu, masa e sigurimit u lehtësua edhe ndaj 2 kolegëve të saj nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila vendosi “arrest në shtëpi” ndaj tyre.


2 kontrollorë të tjerë të Aeroportit të Rinasit u referuan nga SPAK për hetime të mëtejshme në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nisur nga kallëzimi i një shtetaseje e cila pretendonte se në mënyrë indirekte asaj i kanë kërkuar ryshfet, me qëllim ofrimin e mundësisë së udhëtimit tranzit drejt Anglisë, nëpërmjet Gjermanisë. Prokuroria vendosi pushimin e çështjes për shkak se pamjet filmike nuk kanë referuar të dhëna provuese, ndërkohë që nga të dhënat zyrtare nuk rezulton që denoncuesja ka përmbushur kriteret e qëndrimit të ligjshëm në shtetin destinacion.

3.2. Trendi i masave të sigurimit personal

⁵ <https://www.reporter.al/greva-e-pare-ne-sektorin-publik-ne-gati-dy-dekada/>

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Masat e sigurimit te kerkuara nga Prokuroria



	Arrest ne burg	Arrest ne shtepi	Paraqitje ne policine gjyqesore	Pezullim detyre
Masat e sigurimit te kerkuara nga Prokuroria	8	5	6	1

Në 8 raste ose rreth 4% të kallëzimeve penale të depozituara rezulton se Prokurori i çështjes ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Në 7 raste kjo masë sigurimi e kërkuar nga ana e organit të akuzës është aprovuar nga përfaqësuesit e sistemit gjyqësor konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor, ndërkohë në 1 rast është vendosur

ndryshimi i kësaj mase sigurimi në “arrest në shtëpi”. Mbetet i paqartë ndryshimi i masës së sigurimit ndaj këtij shtetasi, ndërkohë që ai rezulton se është arrestuar në kuadër të operacionit të koduar “Viza”, ku në bashkëpunim me shtetas të tjerë i premtonte të huajve pajisjen me leje qëndrimi dhe shtetësi shqiptare, kundrejt akordimit të shumës 1000-1500 Euro.

3 prej shtetaseve të gjinisë femërore ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” rezultojnë të kenë ushtruar funksionin e infermiereve në Spitalin Shefqet Ndroqi. Në bashkëpunim me njëra-tjetrën, ato rezulton të kenë krijuar një skemë mashtrimi, e cila u bë publike edhe nga emisionet investigative në vendin tonë. Për këto shtetase, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi caktimin e masës së sigurimit personal 45 ditë, derisa organi i akuzës të paraqiste prova të tjera me qëllim zgjerimin e hetimit dhe zbardhjen e së vërtetës, por pozita procedurale e këtyre shtetaseve, pavarësisht pasojës që solli në jetën e kallëzueses, u lehtësua gjatë procesit gjyqësor. Gjykata e Apelit vendosi që ndaj këtyre shtetaseve të ndryshohej masa e sigurimit duke u mbështetur në gjendjen shëndetësore të tyre, dhe duke caktuar masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vendimmarrje e cila liroi menjëherë të akuzuarat nga sistemi i paraburgimit.

Gjithashtu, një ndër rastet i cili ndërlihd dy krerët e këtij raporti studimor është akuza e referuar nga ana e SHÇBA-së, e shqyrtuar nga SPAK ndaj disa punonjësve me uniformë të stacionit të Policisë Poliçan, Administratorit të Njesisë Administrative Tërpan dhe Kryeplakut të fshatit Çorrogjaf, të cilët në bashkëpunim kishin lejuar kultivimin e bimëve narkotike në territorin ku ushtrojnë detyrat funksionale dhe kompetencat, si dhe kanë favorizuar autorët që kanë kryer kultivimin e bimëve narkotike.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e kërkuar nga prokurori për 5 shtetas, 2 prej të cilëve të gjinisë femërore, u aprovua nga ana e të dyja shkallëve të gjyqimit, pra si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe nga ajo e Apelit. Me përjashtim, të rastit të kontrollores së Aeroportit të Rinasit, e cila për shkak të faktit se është nënë e një fëmije të mitur, pozita e saj procedurale u lehtësua nga ana e Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, favorizim sa i takon lehtësimit të pozitës proceduralo-penale konstatohet edhe ndaj 3 shtetasve, të cilët për shkak të funksioneve të tyre publike me veprimet/mosveprimet e tyre kishin lejuar dhe favorizuar kultivimin e lëndës narkotike cannabis sativa në juridiksionin territorial të Njesisë Administrative.

Rreth 2.8% ose ndaj 6 shtetasve organi procedues kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kjo kërkesë u aprovua edhe nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ndërkohë që asnjë vendimmarrje nuk rezultoi të jetë disponuar nga Gjykata e Apelit, fakt i cili tregon se këto masa sigurimi nuk janë ankumuar. 4 prej këtyre shtetasve ndaj të cilëve janë regjistruar procedimet penale respektive rezultojnë doganierë, të cilët dyshohet se kanë favorizuar disa tregtarë, duke i përjashtuar nga taksat dhe detyrimet doganore.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në përfundim të hetimeve paraprake ndaj 3 zyrtarëve, pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për abuzim me tenderin e ushqimeve për familjet në nevojë, krahas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj tyre. Pjesë e këtij procedimi penal në cilësinë e të akuzuarit rezultonte dhe drejtori i komanduar i Rezervave të Shtetit. 3 zyrtarët pjesë e Komisionit akuzohen për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankande publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 e 25 i Kodit Penal, ndërkohë drejtori i komanduar akuzohet për shpërdorim të detyrës. Gjithashtu, SPAK ka kërkuar caktimin e masës ndaluese “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 K.Pr.P., kërkesë e cila u refuzua nga ana e Gjykatës së Posaçme duke mos caktuar asnjë masë sigurimi ndaj funksionarit publik. Gjatë monitorimit u konstatua se për këtë dosje me katër shtetas nën hetim rezultoi se nga akuza e shkeljes së barazisë në tendera, gjykata e kualifikoi çështjen për shpërdorim detyre dhe më pas shpalli mos kompetencën duke ja kaluar Gjykatës Penale Tiranë. Ekspertët e Qendrës Fol vlerësojnë se praktika të kësaj natyre, të ndjekura ndaj funksionarëve publikë, përveç se reflektojnë një lehtësim jo proporcional dhe të paargumentuar të pozitës penalo-procedurale mund të krijojnë premisa për ndikim në procesin hetimor, ndërkohë që ata vijojnë funksionet e tyre publike në kontakt të vazhdueshëm me provat dhe indiciet objekt hetimi.

3.3. Konkurrimi i disa veprave penale, ndaj autorëve të dyshuar, përfaqësues ose ish përfaqësues të sistemit të drejtësisë

Figura e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” jo në pak raste është kualifikuar si konkurrese në procedime të ndryshme, në të cilat rrethanat faktike kanë shfaqur një miks të një sërë elementësh edhe të figurave të tjera të veprave penale siç janë neni 313 “Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale”; neni 135 “vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”; neni 245/1 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”; neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; neni 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”; neni 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” etj. **Elementi që tërheq vëmendje është se në 7 prej 17 rasteve (ose rreth 41%), në të cilat konstatohet konkurim ndërmjet figurave të ndryshme të veprave penale me atë të shpërdorimit të detyrës, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.**

Pavarësisht se sistemi gjyqësor është nën filtrin rigoroz të një rivlerësimi kalimtar të subjekteve që aktualisht mbajnë funksione si prokuror apo gjyqtar, duket se korrupsioni mbetet një gangrenë e këtij sistemi, ndërkohë që disa gjyqtarë, prokurorë dhe ish funksionarë të këtij sistemi janë shndërruar në subjekt të procedimeve penale, duke pritur që fati i tyre të përcaktohet nga vetë sistemi i drejtësisë. **Vlen për t’u vlerësuar roli proaktiv i qytetarëve që shfaqin besim në strukturat shtetërore, veçanërisht organet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë si dhe struktura e posaçme SPAK për të hetuar, gjykuar dhe dënuar këta funksionarë që pretendohet se kanë cënuar interesin e ligjshëm të shtetasve denoncues.**

6 shtetas ose në rreth 2.1% e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në fushën e korrupsionit, të cilët rezultojnë shtetas të bashkëpandehur të përfshirë në skemën korruptive, me përshtirjen e një gjyqtareje, avokatë, sekretarë gjyqësor, të burgosur dhe familjarë të tyre, rezulton se organi i akuzës ka cilësuar veprat penale nën nenin 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”; 319/a “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare” dhe 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”.

Në **44** raste ose rreth 15.6% e numrit total të procedimeve të regjistruara për veprat penale në fushën e korrupsionit rezulton se subjekte të denoncuar rezultojnë përfaqësues ose ish përfaqësues të sistemit të drejtësisë. Në 7 prej këtyre rasteve ose rreth 16%, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendimmarrje e cila nuk rezulton të jetë ankimuar nga ana e qytetarëve.

Në një rast qytetari e kallëzon gjyqtaren e çështjes pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor prej saj, në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi ajo ka marrë vendim të ndërmjetëm duke caktuar një ekspert topograf në procesin me palë ndërgjyqëse të paditur Bashkinë dhe ZVRPP Tiranë. Duke vënë theksin në mos ushtrimin e të drejtës së ankimit nga ana e qytetarit në një shkallë më të lartë gjyqësore, prokuroria



vendosi mosfillimin e procedimit penal. Një tjetër vendimmarrje e një tjetër gjyqtareje, e cila ka urdhëruar shërbimin përbarimor për ekzekutimin e një vendimmarrje civile, në përfundim të së cilit ka ardhur tjetërsimi i pronës, duket se ka cënuar interesat e një qytetari i cili i është drejtuar Prokurorisë nëpërmjet një kallëzimi penal. Në argumentimin e vendimmarrjes së saj për mosfillimin e procedimit penal, organi i akuzës u mbështet në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut dhe rëndësinë e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor bazuar në nenin 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Vendimmarrjet e disponuara nga përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, sipas argumentit të prokurorit të çështjes, mund të jenë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit.

Një i paraburgosur rezulton të ketë përdorur identitetin e të vëllait i cili nuk ndodhet në territorin e vendit tonë, për të kallëzuar penalisht një prokuror për shkak të hetimit jo të bazuar të ndërmarrë nga ky i fundit për llogari të tij. Për shkak të hetimeve objektive dhe të gjithanshme, të cilat vlerësohen se kanë përmbushur akuzën e ngritur ndaj të paraburgosurit, është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Marrëdhënia e klientit me përfaqësuesin ligjor të zgjedhur prej tij shpesh herë rregullohet në formë informale dhe në rrugë verbale, duke akorduar pagesa me qëllim zgjidhjen e çështjes sipas interesit të kërkuarit dhe brenda një kohe më të shkurtër. **Në 6 raste rezulton se subjekte të dyshuar të kryerjes së veprave penale në fushën e korrupsionit janë kallëzuar avokatë. Në 2 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal, ndërkohë që 3 raste të tjera ende nuk kemi një vendimmarrje nga ana e organit të akuzës.** Pavarësisht se një shtetas ka pretenduar se avokatja e tij i ka marrë një shumë të konsiderueshme të hollash, ai ka deponuar se nuk ka si qëllim që ajo të vuajë dënimin me burgim, elementë i cili ka mjaftuar që prokuroria të vendosë mosfillimin.

Bashkëshorti i një ish gjyqtareje, e cila rezulton të jetë vendosur nën hetimin e SPAK, ka kallëzuar prokuroren e çështjes me pretendimin se shtrirja e hetimit mbi subjektin e tij, duke mos pasur lidhje me çështjen objekt shqyrtimi bie ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe kuadrin ligjor në fuqi. Me pretendimin se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të ndërhyjë në strategjinë e procesit hetimor që ndërmer SPAK, u vendos mosfillimi i procedimit penal.

Por qytetarët nuk kanë qenë të vetmit që kanë depozituar kallëzime ndaj ish ose përfaqësuesve aktualë të sistemit të drejtësisë. Një rast interesant për studim është regjistruar pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka regjistruar kallëzimin e një avokati ndaj një ish prokurori të shkarkuar nga vettingu. Duke bashkëlidhur si prova në kallëzim vendimmarrjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), avokati ka kërkuar sekuestrimin e pasurive të identifikuar si të krijuara në tejkalim të burimeve dhe të ardhurave të ligjshme. Kjo çështje u referua në SPAK, i cili vendosi mosfillimin duke argumentuar se veprimi i kundërligjshëm i deklarimit të rremë të kryer me dashje nga subjekti apo konstatimi i pasaktësive në plotësimin e këtyre deklarimeve ka ndodhur shumë vite më parë, si rrjedhojë kjo vepër penale është parashikuar.

Bazuar në një vendimmarrje të SPAK dhënë në mungesë, **10** shtetas u arrestuan nga ana e forcave të rendit, **9** prej të cilëve të akuzuar për korrupsion pasiv, ndërsa 1 prej tyre në funksionin e ekspertit dyshohej se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 309 K.P. “ekspertim i rremë”. Krahas gjyqtares së arrestuar dhe një avokati, gjatë përgjimeve telefonike të realizuara në mënyrë indirekte u konstatua dhe një skemë korrupsioni ku rezultonin të përfshirë sekretarja e gjykatës, një kirurg dhe dy infermiere. Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj gjyqtares, masë e cila është lënë në fuqi nga kolegët e saj në të dyja shkallët e gjykimit, pavarësisht se gjyqtarja ka depozituar kërkesa për zëvendësimin e kësaj mase sigurimi pasi është nënë e dy fëmijëve të mitur, një prej të cilëve i diagnostikuar me probleme shëndetësore, i cili e ka të domosdoshme praninë e saj. E njëjta qasje e organit të akuzës dhe përfaqësuesve të sistemit gjyqësor në dy shkallët e gjykimit është mbajtur ndaj sekretares së Gjykatës e cila akuzohet se ndërhynte në sistemin shortues të çështjeve, si dhe ndaj avokatit të përfshirë i cili favorizonte klientët të tij ndikuar nga njohja dhe vendimmarrjet e gjyqtares. Masa e sigurimit “arrest në burg” është caktuar dhe lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Apelit ndaj familjarit të të burgosurit, i cili dyshohej se kishte dhënë 6000 Euro gjyqtares së përfshirë në skemën e korrupsionit, në mënyrë që i burgosuri të përfitonte ulje dënimi. **Tjetër praktikë u ndoq nga ana e Prokurorisë për mjekun kirurg të përfshirë në përgjimet telefonike, ndaj të cilit për shkak të mungesës së rrezikshmërisë shoqërore nuk u ekzekutua masa e arrestit. Gjatë kontrollit të ushtruar nga SPAK në zyrën e tij u gjendën një shumë e konsiderueshme parash, por masa e sigurimit “arrest në burg” e caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë u ndryshua nga shkalla e dytë në atë të masës ndaluese “pezullim i ushtrimit të detyrës a shërbimit publik”. Për këtë çështje SPAK ka dorëzuar rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar arrest në burg.**

Gjatë përfaqësimit në sistemin gjyqësor, por edhe në fazën e hetimeve paraprake duket se konkluzioni i akt-ekspertimeve të ndryshme të realizuara nga ekspertë, njohës profesionistë të fushave të ndryshme të jetës, shndërrohet në mbretëshën e provës për procesin, duke përcaktuar dhe fatin e vendimmarrjes konkrete. **Por ndaj 4 ekspertëve qytetarët rezultojnë se kanë depozituar kallëzime përkatëse, por për shkak të sekretit hetimor, nuk ka qenë e mundur grumbullimi i informacionit konkret mbi vendimmarrjet e organit të akuzës.** Në një rast ka qenë vetë SPAK i cili ka referuar për kompetencë pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kallëzimin e depozituar nga ana e sekretarit të një subjekti politik ndaj ekspertit dhe menaxherit të një firme ndërtimi private, të cilët dyshohen se kanë kanosur apo dhunuar pjesëmarrësit në zgjedhje, kanë marrë apo përdorur dokumentat e identifikimit, si dhe kanë kryer korrupsion aktiv në zgjedhje duke ndikuar në këtë proces.


“Policimi në komunitet” dhe krijimi i një marrëdhënie të ndërsjelltë besimi tek oficerët me uniform të Policisë së Shtetit është një platformë kryesisht e zhvilluar në vendet evropiane, metodikë e cila synohet që të implementohet në vendin tonë pas çdo vendimmarrje të ekzekutivitetit që ka në fokus forcat e rendit. Por qytetarët duket se kanë pasur ankesa rreth 20 përfaqësuesve me uniformë, pjesë e Policisë së Shtetit apo Policisë së Burgjeve, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre zyrtar pretendohet se kanë çenuar

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

interesat e ligjshme të qytetarëve. Një element vlerësues është ndërgjegjësimi në rritje i qytetarëve rreth rolit të rëndësishëm që luan SHÇBA dhe SHKBB, pasi jo në pak raste ata i janë drejtuar këtyre strukturave monitoruese dhe verifikuese, për të depozituar kallëzimin e tyre. **Ndaj 7 oficerëve të Policisë së Kallëzuar se kanë përmbushur elementët e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” ose rreth 35%, organi i akuzës vendosi mosfillimin e procedimit penal.** Masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” u caktua ndaj 1 oficeri të policisë, ndërkohë masa e sigurimit “arrest në burg” ndaj 2 oficerëve, të tre të bashkëpandehur në të njëjtin procedim penal të regjistruar lidhur me operacionin e ndërmarrë në Skrapar. 13 raste të tjera ose rreth 65% janë ende në fazën e hetimeve paraprake sekrete nga ana e organeve proceduese. Këto raste kanë si objekt: pretendimet për veprime arbitrare nga ana e forcave të rendit; mungesë e hetimit efektiv të dhunës së ushtruar në ambientet e komisaritit; sanksione të pa argumentuara administrative (gjobë) ndaj qytetarëve për shkelje të masave anti Covid-19 apo vjedhje për shkak të detyrës.

3.4. Qytetarët kallëzojnë, por nuk ankimojnë vendimet e pushimit/mosfillimit

Në 89 raste ose rreth 42%, ekspertët nuk kanë mundur të grumbullojnë të dhëna të plota identifikuese në terren, për shkak të sekretit hetimor që lidhet drejtpërdrejtë me subjektet aktive funksionarë publikë të dyshuar si të përfshirë ose mos ezaurimin e fazës së hetimeve paraprake.



Në masë konstatohen vendimmarrjet e organit të akuzës për mosfillimin e procedimit penal, përkatësisht **103** vendime ose rreth 49%. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk rezulton që të jenë ankimuar nga ana e palëve në proces. Një prej rasteve që paraqet interes për studim është kallëzimi i disa qytetarëve depozituar fillimisht në SPAK, të cilët pretendonin se në kundërshtim me parashikimet ligjore një sërë institucioneve kanë privatizuar ish-

kinostudion. Sipas qytetarëve afëra korruptive pretendohen se janë realizuar nga punonjës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si pasojë e të cilave disa subjekte kanë përfituar mbi 21.000 m² tokë.

Gjithashtu, në rastin e një qytetari i cili ka kallëzuar përfaqësues të OSHEE për shkak të parregullsive të konstatuara në faturat e energjisë elektrike, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e çështjes duke këshilluar njëkohësisht qytetarin për t’ju drejtuar Gjykatës Administrative.



Një tjetër qytetar rezulton të ketë depozituar kallëzim penal ndaj dekanes dhe disa anëtarëve të stafit akademik të departamentit të stomatologjisë, duke pretenduar përvetësim të fondeve publike dhe përfitimin e padrejtë të tyre në organizatat private të ngritura prej saj, heqje të padrejtë nga puna të disa anëtarëve të stafit, si dhe shpërdorim i burimeve njerëzore gjatë aktiviteteve të kryera nga subjektet private të ngritura. Pavarësisht se të dhënat identifikuese të kallëzuesit nuk përkonin me adresat e deklaruara prej tij, organi i akuzës në përfundim të hetimeve paraprake konkludoi se Universiteti i Mjekësisë Tiranë funksionon mbi bazën e arkëtimeve, ndërkohë që aktivitetet e realizuara nuk janë kostuar.

Arratisja e një shtetasi nga Komisariati nr. 1 Tiranë ka bërë që ndaj 3 oficerëve të policisë të ngrihen dyshime për shpërdorim detyre. Bazuar në raportin mjeko-ligjor të lëshuar nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) rezulton se shtetasi që është arratisur ka ndërmarrë akte të dhunshme ndaj policëve. Kjo çështje u mosfillua nga prokuroria me argumentin se nuk kanë shpërdoruar detyrën.

Ish drejtori i menaxhimit të aseteve pranë Ministrisë së Brendshme u kallëzua nga një ish punonjëse, me pretendimin se prej tij ishin bërë publike të dhëna të klasifikuara si sekret shtetëror për BunkArt, por nga ana e organit të akuzës u vendos mosfillimi me pretendimin se funksionari publik i denoncuar nuk ishte personi përgjegjës për deklasifikimin e informacionit konkret, ndërkohë që lidhur me përfaqësimin ligjor të entitetit publik lidhur me një mosmarrëveshje pronësore në Jalë u argumentua se funksionari e ka marrë zyrtarisht detyrën pasi kjo pronë është privatizuar. Një tjetër ish specialiste juriste ka kallëzuar penalisht funksionarë të lartë, në nivel drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas kallëzueses pretendohet se funksionarët gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në rrugë joligjore nuk kanë respektuar afatet për privatizimin e repartit nr. 71 tek ish NPV. Duke qenë se kjo çështje nuk përmbante elementë të figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, Prokuroria këshilloi palën që të ndiqte shqyrtimin gjyqësor administrativ për zgjidhjen e çështjes, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky objekt kallëzimi, pra repartit nr. 71 rezulton të ketë shërbyer si indicie në depozitimin e kallëzimit me palë të paditur Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH). Mos lejimi për publikimin e një raporti, i cili do të evidentonte shkelje të rënda procedurale në dhënien e disa pronave publike me qera nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, pretendohet se ishte shkak se pse juristja ishte larguar nga detyra. Edhe në këtë rast, Prokuroria mbajti të njëjtin qëndrim duke argumentuar mungesën e anës objektive të figurës së veprës penale.

Bluzat e bardha kanë qenë jo pak herë gjatë vitit 2021 subjekt i kallëzimeve penale të depozituara nga ana e qytetarëve. Nisur nga rëndësia që iu kushtua sistemit shëndetësor, gjatë periudhës së përhapjes së pandemisë Covid-19, u vendos në pikëpyetje jo rrallë herë cilësia e shërbimit mjekësor të ofruar në spitalet civile publike. Një qytetare zgjodhi që në rrugë elektronike të përcillte ankesën e saj drejt Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila e referoi çështjen në Prokurorinë e Tiranës. Qytetarja pretendonte se një mjek i QSUT-së kishte refuzuar që ta mjekonte, duke e udhëzuar që t'i drejtohej një subjekti privat, në të cilin dukej se mjeku ushtronte funksionin në kohën e lirë. Bisedat Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

audio të regjistruara nga ana e qytetares me mjekun duket se nuk kanë shërbyer si indicie të mjaftueshme për organin e akuzës, i cili vendosi mosfillimin e procedimit penal.

Edhe në rastet e vendimmarrjeve të Prokurorisë ku është vendosur pushimi i akuzës apo çështjes, për shkak se nuk ka dalë qartë që fakti ekziston ose fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, rezulton se subjektet e kallëzuar janë përfaqësues të enteve publike të rëndësishme si ARRSH, Drejtoria e Tatimeve apo kontrollor pranë Aeroportit të Rinasit. Për shkak të shpronësimit të pronës private nga ARRSH, një qytetar ka zgjedhur t'i drejtohet sistemit gjyqësor, ndërkohë që Gjykata Administrative ka vendosur që autoriteti publik të dëmshpërblejë me një shumë të caktuar qytetarin. Duke qenë se kjo shumë nuk është ekzekutuar brenda afateve të arsyeshme kohore, qytetari i është drejtuar Prokurorisë duke kallëzuar penalisht kreun e institucionit për shpërdorim detyre, por organi i akuzës duke argumentuar se kreu i institucionit nuk ka pasur drejtpërdrejtë përfitime jo/materiale dhe pjesa e detyrimit të pashlyer është planifikuar në vitin buxhetor pasardhës ka vendosur pushimin e çështjes objekt shqyrtimi.

3.5. Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën

24 shtetas ose rreth 8.5% të rasteve janë kallëzuar penalisht se kanë vjedhur duke shpërdoruar detyrën. Vetëm 3 prej këtyre shtetasve rezulton të jenë arrestuar, ndërsa 1 prej tyre është referuar në gjendje të lirë. Shtetasit e tjerë rezulton të jenë kallëzuar. Në 2 raste organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila u la në fuqi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, por u lehtësua nga ana e Gjykatës së Apelit. Në rastin e parë, ku shtetas i kallëzuar rezultonte një korrier, i cili dorëzonte kutitë postare në destinacion dhe pagesat e klientëve i përvetësonte për qëllime vetjake, Gjykata e Apelit ndryshoi masën e sigurimit në atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për shkak se i kallëzuar baba i dy fëmijëve të mitur, ka shlyer dëmin kompanisë bazuar në një marrëdhënie kontraktuale. Ndërkohë në rastin e dytë, infermierja e kallëzuar dyshohet se ka vjedhur paratë e një pacienti të diagnostikuar me Covid-19 dhe të shtruar në spitalin civil, por për faktin se është nënë e dy fëmijëve të mitur prokurorja e çështjes pranë Prokurorisë së Apelit ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit, kërkesë e cila është pranuar nga ana e Gjykatës së Apelit.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të jetë caktuar vetëm ndaj 2 shtetasve, të cilët kanë vjedhur bateritë nga një central i një kompanie interneti. Kjo kërkesë u aprovua edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në rastet e tjera organi i akuzës ende nuk ka disponuar me një vendimmarrje konkrete, ndërkohë që çështjet përmbajnë element publikë dhe tepër sensitivë, të mbrojtura posaçërisht nga parimi i fshehtësisë së sekretit hetimor.

3.6. Figurat e veprave penale të “Përfitimit të paligjshëm të interesave” dhe “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

Rezulton se vetëm 2 procedime penale janë regjistruar nën këtë kualifikim ligjor, ndërkohë që subjektet ndaj të cilave janë depozituar kallëzimet janë punonjës të TIA dhe ish gjyqtar. Në rastin e ish-gjyqtarit të akuzuar për “përfitim të paligjshëm të interesave”, çështje e cila është shqyrtuar nga ana e SPAK pas shpalljes së moskompetencës nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendimmarrje e cila nuk është ankimuar. Ndërkohë në rastin e punonjësit të TIA, i akuzuar për “shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” parashikuar nga neni 258 K.P., rezulton se çështja është ende nën hetim nga organi procedues.

3.7. Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve

Në përfundim të procesit zgjedhor, më 27 Prill 2021, SPAK njoftoi publikun se 33 procedime penale janë regjistruar në këtë institucion, të kategorizuara si vepra penale në fushën e zgjedhjeve, në formën e “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsionit pasiv në zgjedhje”.⁶

Për shkak të sensitivitetit që karakterizon këto procedime dhe faktit se subjektet e përfshira janë përfaqësues të entiteteve të ndryshme publike dhe procesit nën hetim nga SPAK, **ekspertët e Qendrës Fol i referohen vetëm 7 procedimeve penale për të cilat është bërë publik vendimmarrja e gjykatës.**

Ndaj 3 shtetasve ose në rreth 43% të rasteve, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, masë e cila u la në fuqi edhe nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, në dy shkallët e gjykimit. Me veprimet e tyre këta shtetas pretendohet se kanë përmbushur elementët e parashikuara në nenin 328 KP “Korrupsion aktiv në zgjedhje”. Të tre këta shtetas rezulton se janë ndaluar nga ana e specialistëve të Seksionit për Hetimin e Korrupsionit në Drejtoritë Vendore të Policisë Dibër dhe Tiranë. Gjykata e Shkallës së Parë Dibër ka lënë në burg pa afat dy shtetasit, ndërkohë që pritet shqyrtimi i çështjes nga SPAK, të cilit i është referuar për kompetencë ky procedim penal. Në rastin e ndodhur në Tiranë, një prej shtetasve të shpallur në kërkim rezulton kandidat i një subjekti politik, i cili kundrejt shumave monetare ka synuar të ndikojë në vullnetin e zgjedhësve për të marrë pjesë në votime.

Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është kërkuar nga ana e Prokurorisë ndaj dy shtetasve, të cilët kanë rënë në prangat e policisë pas informacioneve të përcjella në rrugë operative. Gjatë kontrollit fizik të realizuar në automjetin me të cilin po udhëtonin në zonën e Bishtit të Kamzës, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 28 zarfë me nga 5000-10000 lekë secili që dyshohen se do të përdreshin për blerjen e votes, si dhe fletë votimi të cikluara për

⁶ <https://spak.al/2021/04/27/njoftim-24/>

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

një subjekt politik. Masa e kërkuar nga ana e organit të akuzës ndaj këtyre shtetasve, është caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ndërkohë 7 raste të tjera, të cilat janë në fazë të hetimeve paraprake nga ana e organit të akuzës, do të analizohen nga ana e ekspertëve të Qendrës Fol në raportet vijuese që do të hartohen. Në një rast kallzimi I subjektit politik I referohet transmetimit dhe shpërndarjes në rrjetet sociale nga institucioni publik i ATSH (Agjencisë Telegrafike Shqiptare) të postimeve të ndryshme të realizuara nga një subjekt politik për kryerje të veprave penale të parashikuara në nenet 248- 328/a KP. Nën hetim gjendet denoncimi për zyrtarë që kallzohen se premtuan pajisjen e qytetarëve me pasaporta bullgare, një nënkryetar bashkie është kallëzuar penalisht, pasi mbliidhte pasaportat dhe letërnjoftimet e banorëve të zonës duke ndikuar në vullnetin e tyre politik. Subjekte të kallëzuar të procedimeve penale rezultojnë dhe nënkryetari i Bashkisë Korçë dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të këtij qarku, pasi nga të dhënat e kallëzimit dyshohet se nëpërmjet një shtetasi shpërndanin para ndaj qytetarëve në këmbim të votës.

Konkluzione:

- **Përfshirja e shtetasve të mitur dhe shtetaseve të gjinisë femërore, në kategorinë e veprave penale në fushën e drogërave, shikohet me shqetësim nga ana e ekspertëve. Pavarësisht se këta shtetas janë proceduar në gjendje të lirë, dhe për pjesën më të madhe në përfundim të hetimeve paraprake konstatohet se organi procedues ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal për shkak të sasisë së vogël së lëndës narkotike të kualifikuar për përdorim vetjak, rezulton se ata janë subjekte recidivistë (përsëritës) të së njëjtës vepër penale ose vepra të ngjashme brenda një periudhë shumë të shkurtër kohore (1-2 muaj). Një situatë e tillë reflekton se politika penale nuk ka dhënë efektet e duhura parandaluese, si rrjedhojë ekspertët rekomandojnë vënien në zbatim të masave alternative të shmangies të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.**
- **Vendimmarrjet e mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të akuzës ose çështjes nuk ankimohen, ndërkohë mbetet e paqartë favorizimi i disa subjekteve të cilët janë arrestuar në kuadër të megaoperacioneve policore, pozita procedurale e të cilëve lehtësohet gjatë shkallëve të gjykimit.**
- **Konstatohet në masë kërkesa e organit të akuzës, e aprovuar nga përfaqësuesit e sistemit gjyqësor për caktimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Edhe pse masa e sigurimit “arrest në burg” sugjerohet**

e aplikueshme si masa e fundit, konstatohet se mbetet masa më e parapëlqyer për përfaqësuesit e organit të akuzës dhe ato të sistemit të drejtësisë.

- Nën veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” rezulton të jenë regjistruar numri më i madh i procedimeve penale. Pjesa më e madhe e këtyre veprave penale janë ende nën hetim paraprak nga organet proceduese, për shkak të sekretit strikt hetimor dhe përfshirjes si subjekte të kallëzuar të funksionarëve publikë, fashikujt hetimorë të këtyre procedimeve nuk ka qenë e mundur të analizohen.
- Përfaqësues të enteve publike, në nivel drejtues apo funksionarë nën statusin e nënpunësit civilë; punonjës me uniformë të Policisë së Shtetit apo Policisë së Burgjeve, si dhe përfaqësues aktualisht në funksion apo ish funksionarë të mekanizmit të sistemit të drejtësisë penale (avokatë, ekspertë të IML-së, prokurorë apo gjyqtarë) rezulton të jenë kallëzuar nga ana e qytetarëve. Në një masë të gjërë vërehet se organi procedues ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke këshilluar në jo pak raste qytetarët për të ndjekur rrugët ligjore të zgjidhjes së çështjes me natyrë civile apo administrative. Qytetarët nuk kanë ankimuar asnjë nga këto vendimmarrje të organit të akuzës, duke shfaqur mungesë besimi të ndjekjes së çështjes dhe përfitimit të drejtësisë.
- Në jo pak raste kur pjesë e procedimit penal janë përfshirë aktorë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë, por edhe përfaqësues të sistemit shëndetësor, organet proceduese kanë ndjekur të njëjtën politikë të caktimit të masave të sigurimit. Mbetet jo e mbështetur në argumente bindëse kjo praktikë, por ekspertët ndajnë qëndrimin që përgjegjësia individuale penale e secilit shtetas të përfshirë duhet të hetohet dhe vlerësohet në mënyrë objektive dhe të gjithanshme, duke nxitur jo vetëm tek publiku por edhe tek subjektet në konflikt me ligjin parimin e ligjshmërisë së barabartë ndaj të gjitha palëve në proces.

Metodologjia e ndjekur nga ana e ekspertëve:

Ekspertët e Qendrës Fol gjatë grumbullimit dhe analizimit të të dhënave studiuat në mënyrë objektive dhe të gjithanshme fashikujt hetimorë dhe vendimmarrjet e dhëna nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit, përkatësisht Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Gjykatave dhe Prokurorive SPAK), si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë. Më konkretisht dispozitat e legjislacionit penal material në themel të veprimtarisë së ekspertëve janë: nenet 135 “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën; 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; 244/a “Korrupsioni aktiv i nënpunësve të huaj publikë”; 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”; 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”; 248 “Shpërdorimi i detyrës”; 256 “Shpërdorimi i kontributeve të dhëna

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

nga shteti”; 257 “Përfitimi i paligjshëm i interesave”; 257/a “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”; 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”; 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; 259/a “Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë”; 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”; 312 “Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit”; 313 “Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale”; 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”; 319/a “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”; 319/b “Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të hua”; 319/c “Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja”; 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”; 319/d “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”; 319/dh “Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj” dhe 319/e “Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja”.

Në analizë të parë të veprave penale të sipërcituara konstatohet se ato janë pjesë e seksioneve I “Vjedhja e pasurisë”, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryer nga shtetasit”, II “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, dhe III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” të Kodit Penal. Nga ana e ligjvënësit, kategorizimi i këtyre seksioneve është parashikuar si pjesë e krerëve III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit” dhe IX “Vepra penale kundër drejtësisë”. Disa prej këtyre figurave të veprave penale janë nën kompetencën e shqyrtimit nga Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

Sa i takon figurave të veprave penale të përfshira në kategorinë e dytë objekt të këtij raporti studimor konstatohet se 10 dispozitat e Kodit Penal i përkasin neneve 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”; 283/a “Trafikimi i narkotikëve”; 283/b “Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës”; 284 “Kultivimi i bimëve narkotike”; 284/a “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”; 284/c “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope”; 284/ç “Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve”; 285/a “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”; 285/b “Hedhja ose braktisja e shiringave” dhe 286 “Nxitja për përdorimin e drogës”. Në këtë fazë të reflektimit të arsyes se përse është zgjedhur kjo kategori e veprave penale, vlen të ritheksojmë që këto figura të veprave penale të parashikuara në kategorinë e II-të objekt monitorimi, u bënë pjesë e legjislacionit material penal në vendin tonë si pasojë e ratifikimit nga vendi ynë i Konventave ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara kundër trafikimit të paligjshëm të drogërave narkotike dhe substancave psikotrope.⁷ Konsiderohet se këto figura të veprave penale kanë si objekt grupor marrëdhëniet juridike të vendosura nga ana e shtetit

⁷ Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me dt. 27 Janar 2001. Për më tepër: https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtmsg_no=VI-19&chapter=6&clang=en

Ky raport studimor u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.



për të siguruar ligjshmërinë dhe kontrollin e prodhimit, kultivimit, tregtimit, shpërndarjes dhe përdorimit të lëndëve narkotike e psikotrope si dhe jeta e shëndeti i personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni material penal, si rrjedhojë ato janë të reflektuara në seksionin VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit”, kreu III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” të Kodit Penal.